

Buxhetimi me pjesëmarrje

Buxhetimi me pjesëmarrje është një mekanizëm që lejon qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrje dhe ngritjen e transparencës në procesin e hartimit të buxhetit.

Kjo praktikë e re financiare ka për qëllim të rritë pjesëmarrjen e zërit të qytetarëve, si dhe ndihmon qeverisjen vendore për të përmirësuar përgjegjësinë mbi buxhetin.

Bashkëpunimi mes qytetarëve, organizatave jo qeveritare, përfaqësues të biznesit dhe pushtetit vendor sjell si rezultat politika financiare më të drejta dhe efektive.

Buxhetimi me pjesëmarrje ndihmon të përputhen nevojat njerëzore me burimet publike, duke reflektuar prioritetet reale të qytetarëve.

Buxhetimi me pjesëmarrje është plotësues i mekanizmave tradicionale në sektorin publik të përgjegjshmërisë politike, administrative dhe ligjore.

Pjesëmarrja në këtë proces është vullnetare, ku të gjitha palët e interesuara gëzojnë mundësi të barabarta për të komunikuar nevojat e tyre për të mirat dhe shërbimet publike.

Nëpërmjet buxhetimit me pjesëmarrje qytetarët evoluojnë nga të qenit vëzhgues pasivë në lojtarë aktivë të zhvillimit lokal dhe administrimit publik.

Buxhetimi me pjesëmarrje u ofron qytetarëve mundësi për të ushtruar vlerat e demokracisë.